



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:057864

Datë: 07.02.2025

Numri i dokumentit: 06820015

C.nr.717/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Adelina Jusufi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. H, me vendbanim në Podujevë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku Associates”, me adresë Ulpiana C-2 2/6, Hy.101, Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me adresë në rr. “Nuhi Gashi”, Podujevë, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i komunës për konteste juridike F. R., me objekt kontesti: Kompensim i ushqimit (shujtave) dhe kompensim i 70% të shpenzimeve të udhëtimit, me vlerë kontesti: 486.40 €, jashtë seance, me datë 07.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. H.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A. H., të ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 161.28 €, dhe atë:

I. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit (shujtave), për periudhën kohore nga data 01.09.2022 e deri me datë 21.11.2022, respektivisht për 65 ditë të pranisë në punë, shumën prej 130.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 06.03.2023 (data e parashtrimit të padisë), deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. në emër të kompensimit të 70% të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 01.09.2022 e deri me datë 21.11.2022, respektivisht për 65 ditë të pranisë në punë, shumën prej 36.40 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 06.03.2023 (data e parashtrimit të padisë), deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. Refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A. H., përtej shumës së aprovuar në emër kompensimit të ushqimit (shujtave) dhe kompensimi i 70% të shpenzimeve të udhëtimit, në shumën prej 320.00 €.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A. H., të ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 99.00 Euro në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A. H., me datën 06.03.2023, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Podujevës- Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e ushqimit (shujtave) dhe kompensimin e 70% të shpenzimeve të udhëtimit, të cilën kërkesëpadi e ka plotësuar-precizuar me datën 25.10.2024 dhe ka kërkuar shumën e përgjithshme prej 486.4 euro €, si dhe i ka kërkuar kamatën prej 8 % si dhe shpenzimet procedurale.

E njëjta në padi dhe në parashtresën për plotësimin-precizimin e padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune duke punuar tek e paditura në SHFMU “Dëshmoret e Kombit”, në Podujevë. Ndër të tjera ka theksuar se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave, të cilat rrjedhin nga Kontrata e Kolektive e Arsimit, e nënshkruar me 18.04.2017, dhe kontratës individuale, nuk ka bërë kompensimin e shujtave (ushqimit) për ditët e pranisë në puna nga 2 euro, si dhe kompensimin e 70% të transportit rrugor, prej datës 01.09.2021, deri më ditët e parashtrimit të kësaj padie, Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin për shumat e lartcekura. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës, 15.12.2024 ka theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit për kompensim të shujtave, dhe transportit rrugore të paraparë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit Para Universitar, të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021. Tutje shton se në nenin 46 të Kontratës Kolektive është paraparë që MASHT-i dhe SBASHK-u të angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për ndarjen e mjeteve financiare për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga neni 35 dhe paragrafët 5,7 dhe 8 të kësaj kontrate, andaj nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve të punëtorëve të arsimit. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me kontratën kolektive. Po ashtu ka theksua se nga vërtetimi i lëshuar nga drejtori i shkollës për periudhën të cilën kërkohet kompensimi i njëjti kaq qenë në pushim pa pagesë. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin të shujtave ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK), për marrjen e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si dhe fakti se e paditura nuk e ka bërë kompensimin e shujtave dhe nuk e ka bërë kompensimin e 70 % të transportit rrugor për një pjese të periudhës se cekur në padi dhe në plotësim të saj.

Kontestuese në mes të palëve është fakti se a ka bazë ligjore për kompensimin e shujtave si dhe për kompensimin e 70 % të transportit rrugor, gjegjësisht a ka të drejtë paditësja në këto të drejta siç pretendon.

Andaj, gjykata, komform nenit 398 të LPK-së, gjeti së kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo duke pasur parasysh se nuk ishte kontestuese lartësia e kërkesëpadisë, si dhe duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje: KKAK) të dt.18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, konkretisht nenit 35 par.7, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë është, për një ditë punë, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionin arsimor”*, si dhe nenit 35 par.5, ku është përcaktuar se: *“Punonjësve arsimorë (anëtarë të SBAShK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.”*.

Gjykata sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit (shujtave) si dhe kompensimin e 70% të shpenzimeve të udhëtimit, e refuzoi kërkesën e paditësit në shumën prej 320.00 €. Përkatësisht prej datës 01.09.2021 deri më datën 31.08.2022, ku sipas vërtetimit me nr. prot 211/2024 të datës 01.08.2024 të lëshuar nga Drejtori i shkollës “Dëshmoret e Kombit” – Podujevë, i njëjti për këtë periudhë nuk ka punuar, dhe ka qenë në pushim pa pagesë, andaj gjykata e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës, dhënë në përgjigjen në padi lidhur me atë se kontrata kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me këtë kontratë, dhe se nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të arsimit, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara, ngase e paditura lidhur me pagesën e kompensimit të lartcekur obligohet në bazë të obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga KKAK, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe nuk si dhe në bazë është relevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Llogaritja e kamatës sa i përket kompensimit të shujtave si dhe i 70% të shpenzimeve të udhëtimit, gjykata e vendosi bazuar në kërkesën e paditëses, si dhe bazuar në nenin 382 par. 2 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Mendimit Juridik për Kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, ndërsa lartësinë e tyre e mbështeti në Rregulloren e Tarifës së Avokatëve të Kosovës e vitit 2017, ndërsa për takse gjyqësore iu referua Udhëzimit Administrativ për Taksa Gjyqësore nr. 01/2017, ku në rastin konkret, e paditura është obliguar që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 99.00 € dhe atë, në emër të përpilimit të padisë shumë prej 78.00 € (sipas shumës së kërkuar për dy kërkesa në një padi) dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21.00 €. Gjykata e refuzoi kërkesën e paditëses për kompensimin e parashtrës për plotësim të padisë, pasi që vlerësoi së është shpenzim i bërë pa fajin e të paditurës, duke pasur parasysh se paditësja të njëjtin plotësim është dashur ta paraqes me anë të padisë dhe për këtë arsye i është kthyer në plotësim padia. Po ashtu, gjykata vlerëson se paraqitja e padive të mangëta, plotësimi i të njëjtave pas kërkesës së gjykatës dhe kërkimi i shpenzimeve për këto plotësime është keqpërdorim i të drejtave në procedurë.

Numri i lëndës: 2023:057864
Datë: 07.02.2025
Numri i dokumentit: 06820015

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.717/23, datë 07.02.2025**

Gjyqtare
Adelina Jusufi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.